Numër: 01/140
Datë: 31.03.2023

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, në pajtim me nenin 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 27.03.2023 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Korrigjohet** Vendimi Nr.01/553, i datës 07.09.2022, me të cilin është vendosur që të riakreditohet institucioni "ECO - EDUCATION CENTER OXFORD", me dy qendra me adresë: Rr. Gjinollëve, Nr.183, në Komunën e Gjilanit, Republika e Kosovë, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 15.10.2022 deri 14.10.2027, për të ofruar; vlerësuar dhe certifikuar këtë kualifikim: **Kurse të Gjuhës Angleze, niveli A1 deri në C1.**

2. **Korrigjimi** i këtij vendimi bëhet tek pika 1.2 dhe 1.3 e vendimit Nr.01/553, i datës 07.09.2022, dhe i njëjti formulohet/korrigjohet si në vijim:

   1.2. Gjilan, qendra **Nr.1**, Rr. Gjinollëve, Nr.183, në Komunën e Gjilanit: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në dymbëdhjetë (12) grupe, respektivisht 3 mësimdhënës me orar të plotë x 8 grupe x 16 kandidatë =384 kandidatë, 6 mësimdhënës me gjysmë orari x 4 grupe x 16 kandidatë =384 kandidatë, e që në total i ka 768 kandidatë për një vitë.

   1.3. Gjilan, qendra **Nr.2**, Rr. Haki Myderezi, Nr.33, në Komunën e Gjilanit: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në dymbëdhjetë

(12) grupe, respektivisht 3 mësimdhënës me orar të plotë x 8 grupe x 16 kandidatë =384 kandidatë, 3 mësimdhënës me gjysmë orari x 4 grupe x 16 kandidatë =192 kandidatë, e që në total i ka 576 kandidatë për një vitë.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni "ECO - EDUCATION CENTER OXFORD", më datë 23.02.2023 ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 01/87 me të cilën ka kërkuar që të korrigjohet pika 1.2 dhe 1.3 e dispozitivit të Vendimit Nr.01/553, i datës 07.09.2022 i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, pasi nuk janë në përputhje me raportin e ekspertëve të akreditimit për numrin e kandidatëve të lejuar.

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të kualifikimeve bazuar në nenin 50 të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa pjesët tjera të dispozitivit dhe arsyetimit të Vendimit Nr.01/553, i datës 07.09.2022 të Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të kualifikimeve, mbeten të njëjta.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit, "ECO - EDUCATION CENTER OXFORD", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Besim MUSTAFA, PhD.EDBA

Kryetar i KD të AKK